



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

LIGJ

(Projekt)

Nr. _____, Datë _____ 2018

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 64/2012, DATË 31.5.2012 “PËR
PESHKIMIN” I NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4, bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 63 riformulohet me këtë përmbajtje”

“63. "Peshkim tregtar artizanal ose peshkim bregdetar artizanal, është peshkimi tregtar që zhvillohet nga anije më të vogla se 12 metra dhe që nuk përdorin vegla peshkimi fundor me ose pa timon, vegla peshkimi me tërheqje të peshkimit pelagjik me timon ose çift pelagjik, rrjeta binjake me timon dhe draga hidraulike.”

2. Pas pikës 83, shtohet pika 83/1 me këtë përmbajtje:

“83/1. “Sistem i monitorimit të anijes” janë pajisjet hardëare & softëare dhe pajisjet MTU (Mobile Transceiver Unit) të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit të cilat realizojnë identifikimin e një anijeje, pozicionin e saj gjeografik, datën, orën, kursin, shpejtësinë dhe që

¹Ky ligj është I përafuar me Rregulloren CE 1379/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 11 dhjetorit 2013 mbi organizimin e përbashkët të tregjeve të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës, që amendon Rregulloren (KE) 1184/2006 dhe Rregulloren (KE) n. 1224/2009 të Këshillit dhe shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 104/2000 të Këshillit.

mundësojnë transmetimin ndërmjet tyre të të dhënave në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe Ministrinë sipas përcaktimeve të nenit 67 të këtij ligji.”

Neni 2

Në nenin 18, pika 5 riformulohet si më poshtë:

“5. Masat e parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni dhe/ose në kuadër të politikave mbështetëse të Zhvillimit Rural dhe Bujqësor, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 3

Në nenin 19, shkronja “h” e pikës 3 riformulohet si më poshtë:

“h) autorizimin e organeve administrative ose enteve të tjera për lëshimin e lejeve ose dhënien e të drejtës së peshkimit të parashikuara në këtë ligj;”

Neni 4

Në nenin 30, pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik. Procedura e konkurrimit publik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Pas nenit 34, shtohet neni 34/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 34/1 Peshkimi bregdetar artizanal

1. Anijet e Peshkimit bregdetar artizanal duhet të jenë të përfshira në një nga format e organizimit të përcaktuara nga pika 1 e nenit 58 të këtij ligji, me qëllim që të kenë të drejtë të hyjnë në burime, për bashkërendimin dhe menaxhimin e peshkimit artizanal në shkallë të vogël.
2. Organizatat sipas pikës 1 të mësipërme mund të jenë të vetme ose të përfshira në kuadër të organizimeve më të gjera dhe që veprojnë në nivel qarku ose kombëtar.
3. Aplikimi për leje peshkimi sipas pikës 1 të nenit 30 të këtij ligji, bëhet në përputhje me planin e menaxhimit të zonës në fjalë.”

Neni 6

Në nenin 44, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Mjetet që përdoren për peshkimin çlodhës - argëtues dhe mënyra e lëshimit të autorizimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”

Neni 7

Në nenin 60, pas shkronjës ç shtohen shkronjat d), dh) dhe e) me këtë përmbajtje:

“d) kryejnë aktivitete të mbrojtjes së resurseve dhe mbikëqyrjes duke caktuar personel për këtë qëllim.

dh) zhvillojnë struktura mbështetëse tokësore për aktivitetet prodhuese (tregjet e vogla të peshkut, qendrat e grumbullimit dhe depozitimit të produkteve, mjetet e transportit etj.);

e) promovojnë nisma për të rritur cilësinë e zënieve nga ana e anëtarëve;”

Neni 8

Neni 61, riformulohet si më poshtë:

“Neni 61

Organizatave të prodhuesve

1. Organizatat prodhuese të peshkimit krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të peshkimit dhe të njohura sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kur është e nevojshme, në momentin e themelimit të organizatës prodhuese, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël.”

Neni 9

Pas nenit 61 shtohen nenet 61/1 dhe 61/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 61/1

Objektivat e organizatave të prodhuesve

1. Organizatat prodhuese në sektorin e peshkimit ndjekin objektivat e mëposhtme:
 - a) nxisin ushtrimin e aktiviteteve të peshkimit fitimprurës dhe të qëndrueshëm nga anëtarët e tyre në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare të peshkimit dhe legjislacionit në fushën e mjedisit, duke respektuar politikën sociale dhe pjesëmarrjen në menaxhimin e burimeve peshkore nëse është e nevojshme;
 - b) parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë zëniet e mundshme jo objekt peshkimi të popullatave tregtare dhe, kur është e nevojshme, bëjnë përdorimin më të mirë, pa

- krijuar treg për zëniet që janë nën dimensionet minimale të përcaktuara për mbrojtje, sipas akteve nënligjore;
- c) kontribuojnë në gjurmueshmërinë e produkteve të peshkimit me qëllim që konsumatori të ketë një qasje dhe informacion të qartë dhe të plotë;
 - ç) kontribuojnë në eliminimin e praktikave të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar.
 - 2. Përveç objektivave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, organizatat prodhuese ndjekin dy ose më shumë objektiva si në vijim:
 - a) përmirësojnë kushtet për vendosjen në treg të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës së anëtarëve të tyre;
 - b) përmirësimin e performancës ekonomike;
 - c) stabilizimin e tregjeve;
 - ç) kontribuojnë në furnizimin me ushqim dhe promovojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, dhe në të njëjtën kohë promovojnë punësimin në zonat bregdetare dhe rurale;
 - d) zvogëlimin e ndikimit mjedisor të peshkimit, duke përfshirë masat për përmirësimin e selektivitetit të mjeteve të peshkimit.
 - 3. Organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva shtesë.

Neni 61/2

Objektivat e Organizatave të peshkimit bregdetar artizanal

- 1. Organizatat e peshkimit bregdetar artizanal:
 - a) Hartojnë dhe zbatojnë një plan menaxhimi për resurset dhe kategoritë ujore, duke mbajtur parasysh edhe specifikat lokale, me ndihmën e kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pa cwnuar kategoritw e tjera të peshkatarëve ose grupeve të tjera të interesit që veprojnë në bregdet, gjithashtu mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me standardet e vetë-rregullimit;
 - b) Kryejnë aktivitete të mbrojtjes së resurseve dhe mbikëqyrjes duke caktuar personel për këtë qëllim.
 - c) Promovojnë iniciativa që synojnë eliminimin e konflikteve me aktivitetet e tjera të peshkimit të kryera në zonën në fjalë;
 - ç) Zhvillojnë struktura mbështetëse tokësore për aktivitetet prodhuese (tregjet e vogla të peshkut, qendrat e grumbullimit dhe depozitimit të produkteve, mjetet e transportit etj.);
 - d) Promovojnë nisma për të rritur cilësinë e zënieve nga ana e anëtarëve;
- 2. Plani i menaxhimit sipas pikës 1 të mësipërme miratohet nga ministri.”

Neni 10

Në nenin 64, bëhën ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

- 1. Pika 1 riformulohet me këtë përbajtje:

“1. Infrastrukturat e peshkimit mund t'i transferohen në menaxhim një organizate peshkimi, me kërkesën e kësaj të fundit”

2. Paragrafi i parë i pikës 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit një organizate peshkimi realizohet sipas kritereve dhe kushteve të mëposhtme:

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Kur infrastrukturat e peshkimit i transferohen në menaxhim një organizate peshkimi, kjo e fundit dorëzon në Ministri një kopje të bilancit kontabël së bashku me anekset e tij, të dorëzuar në administratën tatimore.”

Neni 11

Në nenin 65, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 3 riformulohet me këtë përmbajtje:

“3. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës menaxhon infrastrukturën e peshkimit, sipas njëres prej mënyrave të mëposhtme:

a. menaxhimi i drejtpërdrejtë;

b. menaxhimi nëpërmjet shoqatave të peshkimit, konkretisht të organizatave të prodhuesve, kooperativave ose të menaxhimit të peshkimit;

c. menaxhimi i infrastrukturave të lidhura me peshkimin nga subjektet private;

ç) menaxhimi i kombinuar i përcaktimeve të bëra në shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike.”

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 5, 6, dhe 7 me këtë përmbajtje:

“5. Një organizatë menaxhon dhe mirëmban infrastrukturën e peshkimit që i është transferuar, në përputhje me parimet e mëposhtme:

a. Menaxhuesi i infrastrukturës së peshkimit duhet të përballojë kostot e përdorimit dhe të mirëmbajtjes;

b. Infrastruktura e peshkimit përdoret në mënyrë të drejtë e të barabartë për të nxitur dhe mbrojtur interesat e përdoruesve;

c. Infrastruktura e peshkimit administrohet në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.

6. Në rastin kur infrastruktura e peshkimit i është transferuar një organizate, organizata është e detyruar të lejojë:

a. Çdo mjet lundrues peshkimi, që është pronë ose drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, të përdorë portin ose qendrën e peshkimit që i është transferuar organizatës;

b. Personat, të cilët nuk janë anëtarë të organizatës, të hyjnë në port ose në qendrën e peshkimit;

c. Çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon portin ose qendrën e peshkimit, që i është transferuar një organizate dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e portit ose të qendrës së peshkimit, dhe me rregulloret e organizatës.

- ç. Tarifat që organizata ofron për shërbimet për një mjet lundrues peshkimi, që është pronë a drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, janë më të larta se tarifat për mjetet lundruese të anëtarëve të saj, por, në çdo rast, jo më shumë se dyfishi.
7. Niveli i tarifave propozohet nga organizata dhe miratohet nga ministri

Neni 12

Neni 66, riformulohet si më poshtë:

“Neni 66

Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës

1. Në varësi të ministrisë krijohet Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA).
2. Përveç sa përcaktuar në pikën 3 të nenit 65, DSHPA menaxhon qendrat e ripopullimit të kategorive ujore në vartësi të ministrisë.
3. Organizimi dhe funksionimi i DSHPA-së, sipas pikës 3 të këtij neni, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI